

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Safet Gjici u rikthehet tenderave të dyshimtë pas lirimit nga burgu, në skenë Etjen Xhafaj i Postës, ish kryebashkiaku mbi 100 milionë euro kontrata publike me dy kompani
ADRESA	https://prapaskena.com/2026/09/19/safet-gjici-u-rikthehet-tenderave-te-dyshimte-pas-liri-mit-nga-burgu-ne-skene-etjen-xhafaj-i-postes-ish-kryebashkiaku-mbi-100-milione-euro-kont-rata-publike-me-dy-kompani/
BURIMI	prapaskena.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	19 shtator 2026, 17:31:55 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	19 shtator 2026, 17:30:09 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	7b5ee57e6d7f2f100feb597cc1d960768387616d3632c01f53d35a05c137b770
TEKSTI	61c58cc54e6b0df676bdae4a425bd6cd6434d3df53c7adb37fc3b6720c7bcb10
PAMJA	2d5eebd512dd31f93764f51d691dd499bd8e63832aebbc7371fafa345d176bc4

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	c81817176481c79fa94e2d529c67d7bbf26ccb3d32d7daa4eec2655683e9390a
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	e6de1b535956bbcb0d3f1977997734a5d8ef6212b247caf423164a2e3e3b2297a
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/c81817176481c79fa94e2d529c67d7bbf26ccb3d32d7daa4eec2655683e9390a>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Safet Gjici u rikthehet tenderave të dyshimtë pas lirimit nga burgu, në skenë Etjen Xhafaj i Postës, ish kryebashkiaku mbi 100 milionë euro kontrata publike me dy kompani

Investigim

Publikuar: 19/09/2026

f X



Nga Adriatik Doçi

Pasditën e 24 qershorit 2023, ish kryebashkiaku i Kukësit, Safet Gjici, u arrestua me kërkesë të SPAK për korrupsion pasiv të të zgjedhurve vendor, pas publikimit të videos duke kryer marrëdhënie intime në zyrë me të famshmen Alma K. Pavarësisht 'ngjitjes' në publik për shkak të videos, akuza ishte e sforcuar dhe perceptimi ishte se Safet Gjici bëri burg për një 'gojore', në kushtet kur ish kryebashkiaku mund të ishte hetuar për tendera të dyshimtë dhe pasurinë. Në maj të vitit të kaluar, ku i kishin mbetur edhe 8 muaj vuajtje dënimi, Gjici u lirua nga burgu për shkak të gjendjes shëndetësore të rënduar.

Pas daljes nga burgu, Gjici u është rikthyer tenderave të dyshimtë publikë përmes dy kompanive, të cilat i ka kaluar, besohet formalisht, në emrin e të vëllait, Lavdrim Gjici. Në vitin 2001, Safet Gjici themeloi kompaninë e sigurisë Euro-Gjici, me emër të ndryshuar në Eurogjici-Security. Pesë vite më vonë, në vitin 2006, Safet Gjici themeloi kompaninë e ndërtimit Kevin

Me të lexuarat

Si po i pastron Gledian Llatja paratë e korrupsionit me tendera në ndërtim, bashkëshortja pyet: "Këtu s'është asgjë"

Tiranë: Ftuam në shtëpi 3 djem, ata na përdhuanan, pastaj ftuam 2 po t'financon të tjerë, makinërinë e luftës së

Putinit - Raporti: Si Raiffeisen Bank bën punën në rrethet.

globele, çmimet e karburanteve rriten ndjeshëm për shkak të luftës "Shtetërore"

sërisht Bashkim Ulajn - Në kulmin e protestave për Rrjollin, biznesmeni ...

Construction shpk.

Para se të përfshihej në politikë dhe pasi u emërua prefekt i Kukësit në 2014, Safet Gjici ia dhuron aksionet e të dy kompanive vëllait Lavdrim Gjici. Gjatë 10 viteve të fundit, kompania Eurogjici-Security ka fituar në bashkëpunim tendera publike me vlerë rreth 70 milionë euro. Kompania e ndërtimit të Gjicit, Kevin Construction, për të njëjtën periudhë, ka fituar në bashkëpunim tendera me vlerë rreth 40 milionë euro.

Xhiroja vjetore e Kevin Construction arrin deri në 14 milionë euro (2021), duke pësuar një rënie deri në 600 mijë euro në vitin 2024, kur Safet Gjici ishte në burg. Xhiroja vjetore e Eurogjici-Security kulmon me 3 milionë euro në vitin 2021, duke pësuar një rënie në 1 milionë euro pas arrestimit të Gjicit dhe fitim modest në 2025, 12 mijë euro.

Këto evidenca tregojnë se aktiviteti kryesor i dy kompanive bazohet në paratë publike dhe se suksesi i tyre në tendera publike përcaktohet nga pozitat e Safet Gjicit në raport me pushtetin. Pas një largimi trevjeçar, periudhë që përkon me mbajtjen e Gjicit në burg, dy kompanitë e tij janë rikthyer në sofrën e tenderave publike.

Në 30 korrik 2026, drejtori i Postës Shqiptare, Etjen Xhafaj, ka autorizuar drejtorin e Departamentit të Administrimit, Elion Semanaj, për të firmosur një tender pa konkurrencë, me vlerë 250 mijë euro, për kompaninë e Safet Gjicit, Eurogjici-Security, në bashkëpunim me kompanitë Nazeri 2000 dhe Special Albania Security.

Objekti i tenderit është marrja e sinjaleve të alarmit nga degët e postës dhe regimit në rast tentative për të grabitur paratë. Diferenca mes fondit limit dhe ofertës fituese është vetëm 22 mijë lekë. Mungesa e konkurrencës dhe diferenca e papërfillshme mes fondit limit dhe ofertës fituese nuk e bëjnë domosdoshmërisht tenderin korruptiv, por ngrenë dyshime të forta për paracaktim të fituesve me pazar në tavolinë.

Të dhënat zyrtare tregojnë se Safet Gjici me të njëjtat kompani bashkëpunimi, pothuajse ka monopolizuar tenderat për sigurinë fizike, shoqërimin e parave dhe marrjen e sinjaleve të alarmit të Postës Shqiptare, drejtorive rajonale të OSSH-së dhe sidomos të UKT-së.

Safet Gjici i ka kaluar formalisht bizneset në emrin e të vëllait në vitin 2014, por personat e tij të lidhur, në kuptimin e detyrimit ligjor për deklarimin e pasurisë, kanë vijuar të deklarojnë të ardhura si të punësuar në dy kompanitë e tij, Eurogjici-Security dhe Kevin Construction. Gjithashtu, Safet Gjici ka deklaruar blerjen e pasurive të paluajtshme kur si të ardhura të deklaruara kishte vetëm pagën si kryebashkiak dhe të ardhura nga qiratë.

Safet Gjici deklaroi një pasuri me vlerë miliona euro; vila, apartamente, lokal te Ura e Tavakëve, troje, ullishte, toka, depozita bankare, obligacione 700 mijë euro etj. Burimi kryesor i pasurisë së deklaruar janë të ardhura nga aktiviteti tregtar. Por, Safet Gjici ka deklaruar edhe disa pasuri të paluajtshme me burim të pretenduar lekë të dhuruara nga të afërmit, paga si punonjës pranë Ministrisë së Brendshme, pranë Gardës së Republikës dhe nga punësimi si badigard.

Gjithsesi, vetëm një hetim i mundshëm nga SPAK mund të konfirmonte ose jo nëse Safet Gjici ka përdorur pozitat si ish kryebashkiak dhe lidhjet me pushtetin, duke përfituar tendera publike të paracaktuar dhe në disa raste me marrëveshje me operatorë të ndryshëm ekonomikë, duke devijuar më pas një pjesë të parave në xhepat e tij, para të cilat mund të jenë investuar në pasuri të paluajtshme.

TAG:

Eurogjici Security

Kevin Construksion

Posta shqiptare

Safet gjici

Tendera

Të ngjashme

Qeveria “shpërblen” sërish Bashkim Ulajn - Në kulmin e protestave për Rrjollin, biznesmeni mori leje për resort në Jalë!

Dy turiste suedeze në Tiranë: Ftuam në shtëpi 3 djem, ata na përdhunuan, pastaj ftuam 2 të tjerë, edhe ata na përdhunuan (pas 3 ditësh bënë kallëzim)

Gjykata e Lartë e la në qeli, Veliaj: Grusht institucional ndaj demokracisë vendore

Prapaskena

‘Prapaskena’ lindi si një nismë e një grupi gazetarësh me përvojë dhe plotësisht të pavarur nga çdo parti politike, grup interesash apo klane biznesi, me qëllim për të thënë çdo të vërtetë të guximshme me interes publik. ‘Prapaskena’ është një media e lirë dhe e pakompromis, e cila ka si qëllim informimin e opinionit publik në mënyrë të paanshme, profesionale dhe në dritën e të vërtetës, mbi çështje që lidhen me korrupsionin politik, krimin, pandëshkueshmërinë, grabitjen e pasurive publike, mbi reformat, sfidat kombëtare dhe lidhjet e padukshme mes partive politike, mediave të njësuara me interesat klienteliste, krimin dhe biznesit jo të ndershëm, të cilët në bashkëpunim përvetësojnë paratë dhe pasuritë publike.’

Copyrights

Çdo kopjim, përdorim apo riprodhim i paautorizuar i këtij materiali është i ndaluar dhe mund të sjellë ndjekje ligjore. Ju lutemi respektoni punën dhe përpjekjen tonë duke mos e shkelur këtë parim.

Kategoritë

[KREU INVESTIGIM](#)

[KRIM & KORRUPSION](#) [DOSJE ROZË](#)

[KRYESORE POLITIKË](#) [EKONOMI](#)


[ANALIZË RAJON](#) [KULTURË](#) [SPORT](#)



Email: [\[email protected\]](#)

Copyright © 2025. All Rights Reserved by Prapaskena

[Privacy Policy](#) | [Cookies](#)



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.